REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 60, datë 13.08.2026

PËR
REFUZIMIN E APLIKIMIT PËR LEJE ZHVILLIMI PËR OBJEKTIN: "DHOMA AKOMODIMI DHE AMBIENTE SHËRBIMI ME STRUKTURA TË LEHTA (BUJTINA)", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË SHKODËR

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Nenit 10/2 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" e ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Refuzimin e aplikimit për Leje Zhvillimi për objektin: "Dhoma akomodimi dhe ambiente shërbimi me struktura të lehta (bujtina)", me vendndodhje në Bashkinë Shkodër, me subjekt zhvillues shoqërinë "Cinco Summer" sh.p.k.

2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

4. Kundër këtij Vendimi, lejohet ankim nga pala e interesuar, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Ligj Nr. 44/2015 "Kodin e Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

K R Y E T A R I

E D I R A M A

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 30/10/2026